



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



DREJTORIA E BUJQËSISË

THIRRJA PËR APLIKIM

Njoftohen të gjithë bletarët e komunës së Prishtinës se mund të aplikojnë për pajisje në lëmin e bletarisë.

Kriteret:

- Aplikuesi duhet të jetë banorë i komunës së Prishtinës;
- Duhet të ketë sipërfaqe të tokës, së paku 0,02 ha, në territorin e komunës së Prishtinës;
- Përkrahen bletarët që kanë 10 shoqëri bletësh e më shumë;
- Përfituesi duhet ta ketë pronën në territorin e komunës së Prishtinës dhe të jetë banor i saj;
- Përkrahja e fermerëve do të bëhet me centrifugë elektrike 4 kornizëshe, me material inox, koshere 2 kateshe antivaro, depozitor mjalti 50 kg, kuti ushqyese 2l dhe bluza për bletarë;
- Për përfitimin e centrifugës elektrike përparësi do të kenë bletarët me numër më të madh të shoqërive të bletëve;
- Përfituesi i pajisjes së centrifugës elektrike 4 ramshe nuk mund të jetë edhe përfitues për pajisje të tjera ose anasjelltas;
- Nuk mund të jenë përfitues bletarët ose anëtarët e ngushtë të familjes, të cilët janë përkrahur nga Komuna dhe donatorët e saj në projektet e ngjashme në 3 vitet e fundit.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopja e një dokumenti identifikues valid i Republikës së Kosovës;
- Certifikata mbi pronësinë e paluajtshme, me afat deri në një vit;
- Certifikata e lindjes;
- Deklarata e bashkësisë familjare;
- Vërtetimi i tatimit në pronë.

Data e aplikimit: 31.10.2019 – 14.11.2019